



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË



V E N D I M

Nr. 75 datë 28.10.2022

“Për ndryshimin e vendimit nr 35 datë 26.05. 2022 të marrjes me qira me afat 9 (nëntë) vjecar te sipërfaqes pyjore prej 2.1 ha duke ndryshuar menyren e perdorimit : nga depozitim materialesh inertë me siperfaqe 0.1 ha, për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore, për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë) me siperfaqe 2 ha total 2.1 ha, ne park fotovoltaiq”, (aerogjeneratore, stacionet, objektet perkatese etj).

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 57/2020, date 30.4.2020 “Për Pyjet”, neni 25, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënje në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” *me shumicë të cilësuar votash.*

V E N D O S I

Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej 2.1 ha në ngastrën nr. 14, Ekonomia Pyjore **Drin Gjader Kirë , park fotovoltaiq”, (aerogjeneratore, stacionet, objektet perkatese etj).**

1. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për vëprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore” shtojca nr 1 pika 8:6.
2. Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti , sigurohen të ardhura të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
3. Ngarkohen Drejtoria e pyjeve, Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

K R Y E T A R
Mark Bisha

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Ardian Çelepija

Miratuar me 21 vota

Vota Pro 21

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 02.11 2022





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Of. 6186/1 Prot
Dt. 16.11.22

Nr. 744/5 Prot.

Shkodër, më 11.11.2022

Lënda: Mbi Vendimin nr. 75, datë 28.10.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Për informim: **ZYRËS SË ADMINISTRIMIT TË BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brëndshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja “a”, neni 18, neni 27, pika 5, neni 54, shkronja “e/1”, neni 55, pika 3, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, neni 25, pika 1, shkronja “b”, të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave te inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar, pika 49, shtojca 47, të VKM nr. 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, shtojca 1, pika 3, të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkitimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”, të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 6175 prot., datë 02.11.2022 dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, shqyrtoi *VKB Vau Dejës nr. 75, datë 28.10.2022 për ndryshim të VKB nr. 35, datë 26.05.2012 të marrjes me qira me afat 9 vjeçar të sipërfaqes pyjore prej 2.1 ha duke ndryshuar mënyrën e përdorimit, nga depozitim inertesh me sipërfaqe 01. Ha, për qëllime pushimi, shëndetësore, shoqërore, për veprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhëse) me sipërfaqe 2.1 ha në total, në park fotovoltaiq, (aerogjeneratorë, stacionet, objektet përkatëse etj.), në ngastrën nr. 14, ekonomia pyjore Drin Gjadër Kir, sipërfaqe kjo sipas shkresës së ZABU Drin-Bunë nr. 237/1 prot., datë 05.07.2022 “Kthim përgjigje kërkesës për trajtim¹”, përfshihet në brigjet e lumit Drin dhe konfirmohet se janë nën administrimin e Zyrës së Administrimit të Baseni Drin-Bunë.* Për një situatë të tillë, këshilli bashkiak ka miratuar vetëm dhënien në përdorim, tagër i tij sipas procedurave të konkurrimit publik, por struktura përgjegjëse në bashki është e detyruar të respektojë kriteret e nenit 66, paragrafi i dytë dhe nenit 67 të ligjit Nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, kjo edhe sipas shkresës së strukturës së specializuar Agjensia e Menaxhimit të Burimeve Ujore me nr. 1108/1 prot, datë 23.10.2020. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T

Majlinda ANGONI

¹ Jeni ngarkuar me detyrimin për marrjen e autorizimit të posaçëm për ushtrim aktiviteti nga ZABU Drin-Bunë